

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6585
E premte, 15 prill 2022
çmimi 0.40 €

Reagim i KMDLNj-së | FAQE 7

Kosova nuk ka pse të merret me Dick Martyn, po e luan rolin e Pont Pilatit!



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA VIZITUAR KOMUNËN E MITROVICËS

OSMANI: ME ARMATOSJEN NGA KINA DHE RUSIA, SERBIA PO TREGON SE NUK DO PAQE



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se armatosja e Serbisë nga Kina, por dhe Rusia në dekadën e fundit, tregon se Beogradi nuk është "i interesuar për stabilitet dhe paqe" në rajonin e Ballkanit Perëndimor. "Armatimi i Serbisë nuk po ndodh vetëm tani. Tani ka marrë përmasa edhe shqetësuese por, siç e dini, në raport me Rusinë dhe Kinën, ajo është janë duke e rritur armatimin, minimum në dhjetë vjetët e fundit dhe kjo tregon që Serbia nuk është e interesuar për paqe dhe stabilitet në rajonin tonë", ka thënë presidentja Osmani | FAQE 4

AKTUALE



PUTINI I AKUZON BANKAT PERËNDIMORE QË NUK PO PAGUAJNË PËR GAZIN RUS F. 2

KRYESIA E PDK-SË MIRATON STRUKTURËN E KABINETIT TË QEVERISJES SË MIRË F. 3

DEPUTETËT VOTOJNË NË PARIM PROJEKTLIGJIN PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS F. 5

EKONOMI



RRITJA E PAGËS MUND TA RREZIKOJË KONTRATËN F. 8

GRIPI I SHPEZËVE DHE LUFTA NË UKRAINË RRYTIN ÇMIMIN E VEZËVE F. 8

SPORT



ORGANIZATORËT PREMTOJNË SPEKTAKËL NË FINAL 4 TË LIGËS UNIKE F. 6

Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria Speciale 'përplasen' për rastin e vdekjes së Astrit Deharit | FAQE 5



MINISTRIA E ARSIMIT KËRKON NGA GJYKATA PROVA NËSE E KA SHKELUR KUSHTETUTËN

| FAQE 4

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Putini akuzon bankat perëndimore se nuk po paguajnë për gazin rus

MOSKË, 14 PRILL - Presidenti rus Vladimir Putin i ka akuzuar bankat perëndimore se po dështojnë t'i kryejnë pagesat për gazin rus. Këto deklarata të bëra më 14 prill vijnë dy javë pasi lideri rus kërkoi që pagesat për gazin rus të bëhen me rubla. "Ka mospagesa të dërgesave të eksportit të burimeve të energjisë ruse", ka thënë Putini gjatë një takimi lidhur me zhvillimin e sektorit të energjisë së Rosisë. Pjesë e kësaj mbledhjeje u transmetua në televizionin shtetëror rus.

"Bankat nga këto shtete jashtëzakonisht jomiqësore nuk po realizojnë transferimin e pagesave", ka deklaruar Putini.

Në fund të marsit, Putini kishte kërkuar nga shtetet e Bashkimit Evropian që të paguajnë me rubla për gazin rus, një lëvizje që Rusia po tenton ta zbusë ndikimin në ekonominë e saj të sanksioneve perëndimore. Qeveritë perëndimore kanë vendosur sanksione të ashpra ndaj sistemit financiar dhe ekonomisë ruse, pasi Moska

nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Blerësit e gazit rus mund të hapin një llogari në Gazprombank dhe t'i depozitojnë paratë në dollarë dhe euro, siç kishin bërë më parë. Banka më pas i konverton ato në rubla dhe ia transferon "Gazprom"-it, gigantit rus të energjisë.

Teksa liderët perëndimorë po shikojnë për mundësi të reja që ta ndalin sulmin e Rosisë ndaj Ukrainës, Putini paralajmëroi kundër çdo embargo mbi



gazin dhe naftën ruse, ashtu siç ka kërkuar Kievi. "Pasojat e një hapi të tillë mund të jenë

shumë të dhimbshme, veçmas për iniciatorët e kësaj politike", ka thënë Putin.

Ukraina sulmon një luftanije ruse në Detin e Zi

KIEV, 14 PRILL - Ukraina thotë se ka sulmuar me raketa një anije ruse në Detin e Zi dhe e ka dëmtuar rëndë të njëjtën, teksa Moska po zhvendos fushatën e saj ushtarake në lindje dhe luftime të ashpra po vazhdojnë në qytetin-port ukrainas të Mariupolit.

Ministria ruse e Mbrojtjes ka njoftuar më 14 prill se një raketë lundruese ka shkatërruar municionet në anijen Moskva, por Maksym Marchenko, guvernator ukrainas në Odesa, që gjendet në Detin e Zi, tha se anija ruse u godit me dy raketa ukrainase "Neptun", raketa që përdoren për t'i sulmuar anijet. "Raketat 'Neptun' në Detin e Zi kanë shkakuar dëme serioze ndaj anijes ruse", tha ai në një postim në "Telegram". Sulmi i Rosisë ndaj Ukrainës ka hyrë në ditën e 50.

Këshilltari i Presidencës ukrainase, Oleksiy Arestovych, tha se me luftanijen ruse Moskva "ndodhi befasia", pasi kjo luftanije konsiderohej kyçe në çdo plan që Rusia mund të ketë pasur për të nisur sulme amfibe në qytetin bregdetar ukrainas të Odesës.

Ministria e Mbrojtjes e Rosisë tha se zjarri në anije është shuar dhe se e njëjta "është në det" dhe se "armatimet me raketa" të saj janë të padëmtuara.

Ende nuk ka ndonjë reagim nga Ministria e Mbrojtjes e Ukrainës, por Rusia tha se ka evakuuar



ekuipazhin e anijes.

Zëdhënësi i Pentagonit, John Kirby, ka thënë se Shtetet e Bashkuara nuk kanë informacione të mjaftueshme për të konfirmuar se çfarë e shkaktoi shpërthimin në Moskva. "Ne kemi parë raportimet në mediet sociale se kjo anije mund të jetë goditur nga raketat ukrainase. Ne nuk mund ta

përrjashtojmë këtë gjë, por ne thjesht nuk kemi informacione të bollshme tani për tani", ka deklaruar Kirby në një intervistë për MSNBC.

Lajmet për sulmin ndaj kësaj luftanijeje ruse vijnë teksa lufte të ashpra janë raportuar në qytetin e rrethuar të Mariupolit. Rusia po tenton që ta marrë kontrollin e plotë të këtij qyteti strategjik.

Nëse Mariupoli bie nën kontrollin rus, atëherë ai do të ishte qyteti i parë që Moska merr nën kontroll që prej se nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Rusia ka njoftuar se mbi 1 000 marinsa janë dorëzuar gjatë 36 orëve të fundit, por zyrtarët ushtarakë ukrainas nuk kanë konfirmuar këto pretendimeve

dhe vetëm kanë thënë se forcat ukrainase janë të bashkuara që ta mbrojnë qytetin.

Rusia po tenton që ta marrë Mariupolin, pasi do t'i mundësonte që të krijonte një korridor tokësor midis rajoneve lindore që janë nën kontrollin e separatistëve pro-rusë dhe Gadishullit të Krimesë që Rusia e ka aneksuar më 2014.

Policia gjermane arreston katër persona të lidhur me një grup ekstremist

Berlin, 14 prill - Hetuesit gjermanë kanë kryer kontrolle në nëntë shtete kundër anëtarëve të një grupi bisedash që dyshohet se planifikonin të vendosnin eksploziv dhe të rrëmbenin "personazhe të njohura publike".

Prokurorët në Koblenz të Gjermanisë perëndimore thanë se bastisjet u kryen të mërkurën në 20 prona gjithsej, me rreth 270 oficerë të angazhuar, duke përfshirë

njësitë speciale të policisë.

Objektivat e bastisjeve ishin pesë persona në të 40-at dhe 50-at. Ata akuzohen për përgatitje të një akti të rëndë dhune në kërcënim ndaj shtetit dhe shkelje të legjislacionit për armët.

Gjatë kontrollit u sekuestruan armë, municion, para të gatshme, shufra ari dhe monedha argjendi.

Njerëzit në grupin e bisedave "Vereinte Patrioten" (Patriotët

e bashkuar) thuhet se synonin t'i shkatërronin objektet e furnizimit me energji elektrike në mënyrë që të shkaktonin një ndërprerje mbarëkombëtare të energjisë, rrjedhimisht të shkaktojnë "kushite të ngjashme me luftën civile", tha zyra e Prokurorit të Përgjithshëm në shtetin e Rheinlandit.

Hetimi i aktivitetit të dyshimtë të grupit kishte nisur në tetor të vitit të kaluar.



Osmani: Me armatosjen nga Kina dhe Rusia, Serbia po tregon se nuk do paqe



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se armatosja e Serbisë nga Kina, por dhe Rusia në dekadën e fundit, tregon se Beogradi nuk është “i interesuar për stabilitet dhe paqe” në rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Armatimi i Serbisë nuk po ndodh vetëm tani. Tani ka marrë përmasa edhe shqetësuese por, siç e dini, në raport me Rusinë dhe Kinën, ajo është janë duke e rritur armatimin, minimum në dhjetë vjetët e fundit dhe kjo tregon që Serbia nuk është e interesuar për paqe dhe stabilitet në rajonin tonë”, ka thënë presidentja Osmani

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se lideri i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, po vazhdon mendësinë e ish-presidentit të Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq. Duke i komentuar deklaratat e Vuçiqit, i cili ka kritikuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Malit të Zi, Millo

Gjukanoviç, presidentja e Kosovës ka thënë se nuk befasohet nga “gjuha e ministrit të Millosheviqit”. “Aleksandër Vuçiqi ka qenë ministër i Propagandës gjatë luftërave në ish-Jugosllavi, të shkaktuara nga ish-shefat e tij dhe, për fat të keq, edhe tani edhe në vitin 2022 po e dëshmon logjikën e njëjtë të shekullit të kaluar. Akoma nuk e ka dënuar asnjë nga krimet e regjimit të Millosheviqit. Përkundrazi,

vazhdon ta glorifikojë Millosheviqin dhe ta shfajësojë atë për krimet e kryera në Kosovë. Akoma nuk i ka vendosur para drejtësisë kryerësit e krimeve dhe masakrave të shumta, përfshirë gjenocidin ndaj popullatës së pafajshme civile në Republikën e Kosovës”, ka thënë Osmani në një konferencë për medie në Mitrovicë të enjten pasi është takuar me kryetarin e këtij qyteti, Bedri Hamza.

Vuçiqi më 13 prill, duke folur për deklaratat e Kurtit dhe Gjukanoviçit, që kanë kritikuar Serbinë për blerje të armatimit nga Kina, tha: “Unë më me dëshirë do të isha gjithmonë një ujk i vetmuar sesa një hienë e paturpshme dhe e pamoralshme... Është edhe më keq të jesh mizë që sillet rreth hienës dhe pret t'i sillet një pre, siç janë Kurti dhe Gjukanoviç”. Një ditë më parë Kurti ka thënë se Serbia me blerjen e

armatimeve po tenton ta forcojë veten sepse, sipas tij, “ndoshta mund të ngelet e vetmuar”.

Ndërkaq, Gjukanoviçiqi tha se Serbia po vazhdon të blejë armë nga “armiç të dukshëm të Evropës dhe NATO-s”.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se armatosja e Serbisë nga Kina, por dhe Rusia në dekadën e fundit, tregon se Beogradi nuk është “i interesuar për stabilitet dhe paqe” në rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Armatimi i Serbisë nuk po ndodh vetëm tani. Tani ka marrë përmasa edhe shqetësuese por, siç e dini, në raport me Rusinë dhe Kinën, është duke e rritur armatimin, minimum në dhjetë vjetët e fundit dhe kjo tregon që Serbia nuk është e interesuar për paqe dhe stabilitet në rajonin tonë, por tregon se akoma dëshiron të shkaktojë destabilitet, edhe e ndikuar nga Rusia, satelit i së cilës Serbia është”, tha Osmani. Sipas presidentes së Kosovës, Serbia vetëm deklaroi se është për rrugën evropiane por, sipas saj, ky shtet është në “rrugën e [presidentit të Rusisë, Vladimir] Putinit”.

Në ditët e fundit në Serbi arritën sisteme kundërajrore kineze FK-3. Sisteme të tilla janë të ngjashme me sistemin rus S-300, apo atë amerikan Patriot.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar se blerja e sistemeve të tilla është “legjitime, plotësisht e rregullt dhe transparente”.

Si Brukseli, ashtu edhe Uashingtoni, kanë shprehur vazhdimisht shqetësimin e tyre për blerjet e armëve nga ana e Serbisë në Rusi dhe Kinë, sepse Serbia, si vend kandidat për anëtarësim në BE, pritët ta harmonizojë politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë me bllokun evropian.

Po ashtu, qeveria gjermane, pas lajmit të arritjes së armatimit nga Kina, i bëri thirrje Serbisë që ta përshtatë politikën e jashtme dhe të sigurisë me Bashkimin Evropian.

Kryesia e PDK-së miraton strukturën e Kabinetit të Qeverisjes së Mirë

PRISHTINË, 14 PRILL (ER) - Kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën ka marrë disa vendime me rëndësi. Pas aprovimit të rregullores për organizim dhe funksionim të Kabinetit të Qeverisjes së Mirë nga Këshilli Drejtues, Kryesia e PDK-së ka miratuar strukturën e Kabinetit për Qeverisje të Mirë, duke përcaktuar përbërjen e departamenteve të QKM-së dhe dikasteret që do të jenë pjesë e tyre.

Po ashtu, është emëruar komisioni për organizim të PDK-së në mërgatë, i përbërë nga 11 anëtarë dhe i udhëhequr nga deputeti Elmi Reçica, që do ta vazhdojë punën e bërë nga ish-Departamenti për Diasporë. Në vazhdim të reformave dhe të konsolidimit të Partisë Demokratike të Kosovës, në pajtim me vendimin e mbledhjes së fundit të Këshillit Drejtues, si dhe në bazë të nenit 31 të statutit, kryesia e PDK-së ka vendosur që ta caktojë udhëheqësinë e përkohshme

në Degën e PDK-së në Kamenicë, me kryetar Granit Berisha, e cila ka përgjegjësi t'i konsolidojë të gjitha strukturat e degës deri në mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta në PDK. Përveç vendimeve të marra, kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës ka diskutuar sot edhe për zhvillimet e fundit politike në vend, ku PDK-ja si lidere e opozitës po luan rolin e saj demokratik për mbikëqyrjen e punës së qeverisë dhe ofrimin e alternativave për të gjitha çështjet me rëndësi për vendin.



Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria Speciale 'përplasen' për rastin e vdekjes së Astrit Deharit

PRISHTINË, 14 PRILL (ER) - Ministria e Drejtësisë e ka akuzuar Prokurorinë Speciale të Kosovës se ka manipuluar dhe propaganduar me ekspertizën e Institutit Zviceran për rastin e Astrit Deharit. Sipas MD-së, nga Prokuroria Speciale janë publikuar vetëm dy nga konkluzionet e raportit, nga pesë sa janë gjithsej. Përmes një komunikate për medie, MD-ja thotë se publikimi i raportit nga Prokuroria Speciale ende pa e pranuar familja raportin "dëshmon për mangësi të theksuar intelektuale, mungesë totale të njohurive shkencore, gjuhë krejtësisht joprofesionale dhe qëllim dashakeq. Jemi të zhgënjyer me këtë qasje!". "Nxitimi me komunikatë nga Prokuroria Speciale sikurse deklaratat e menjëhershme asokohe të kreut të policisë dhe të Prokurorisë Themelore në Prizren, në mënyrë të ngjashme na rikthehen sërish me deklaratat të Prokurorisë Speciale, pa kurrfarë nevojë për këtë nxitim. Kujt i kontribuon një manipulim i tillë, ku publikohen konkludime të pjesshme? Si organet e drejtësisë mund të jenë kaq tendencioze dhe selektive, veçmas një organ siç është

prokuroria, e cila nuk guxon t'i shpërfillë asnjë nga hetimet që bëhen për asnjë rast të caktuar", thuhet në reagimin e MD-së. Mes të tjerash, thuhet se Astrit Dehari ka vdekur në duart e shtetit dhe se "papërgjegjësia e organeve të shtetit ka prodhuar edhe këtë situatë të kobshme". Ndërsa sipas ministrisë, papërgjegjësia e sërishme e organeve, në këtë rast e Prokurorisë Speciale, po tenton "ta vrasë" zbardhjen e drejtësisë. "Përkundër pengesave që kanë vendosur, individë apo grupe të ndryshme, të cilët tentojnë ende që ta pamundësojnë zbardhjen e rastit Dehari, ato nuk mund ta sfidojnë në tërësi drejtësinë. Ministria e Drejtësisë bën sërish të qartë, që në mandatin e saj, përbrenda kompetencave që ka do të ndërmerret çdo hap, çdo veprim për ta forcur në njërin anë sistemin e drejtësisë dhe do t'i përgjigjemi secilës kërkesë për drejtësinë e plotë për Astrit Deharin", thuhet në reagimin e MD-së. Prokuroria Speciale e Kosovës ka reaguar pas akuzave përse ka manipuluar dhe propaganduar me ekspertizën për rastin Dehari.



Në reagim thuhet se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ia bën të qartë Ministrisë së Drejtësisë, por edhe opinionit të gjerë, se nuk kanë komentuar raportin, por vetëm se kanë publikuar konkluzionet e raportit të ekspertizës të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, lidhur me rastin e Astrit

Deharit. "Prokuroria Speciale siguron opinionin se në asnjë mënyrë nuk ka manipuluar me prova, por vetëm se ka prezantuar mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Lozanës në Zvicër. Andaj, pretendimet tendencioze dhe dashakeqe të Ministres së Drejtësisë, karshi

Prokurorisë Speciale, janë të paqëndrueshme si dhe kanë për qëllim dezinformimin dhe manipulimin e opinionit publik. Andaj, kushdo që ka ndonjë dyshim mbi këto përfundime, le t'i drejtohet Institutit të Mjekësisë Ligjore të Lozanës për informacione shtesë", thuhet në reagim.

Ministria e Arsimit kërkon nga gjykata prova nëse e ka shkelur Kushtetutën

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 PRILL - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese ofrimin e provave në katër elementë në të cilat ka konstatuar se është bërë shkelje kushtetuese me vendimin e MASHTI-t për organizim të mësimin alternativ të përshpejtuar në komunën e Kamenicës. Valdrin Dervishaj, këshilltar i ministres së këtij dikasteri, Arbërie Nagavci, ka thënë se në shkresat e lëndës së dorëzuar nga gjykata nuk ka asnjë provë që dëshmon se MASHTI ka realizuar një nga këto veprime. "Bazuar në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike të datës 04.07.2019, sot në mëngjes kam parashtruar kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese për qasje në: Provat të cilat dëshmojnë se Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka organizuar mësimin alternativ të përshpejtuar; Provat të cilat dëshmojnë se Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka angazhuar mësimdhënësit shtesë për të organizuar mësimin alternativ të përshpejtuar; Provat të cilat dëshmojnë se Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka lëshuar certifikata për nxënësit pas përfundimit të procesit të mësimor; Provat të



cilat dëshmojnë se Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit shprehimisht ka caktuar vendin se ku do të organizohet mësimin alternativ të përshpejtuar", ka shkruar Dervishaj në llogarinë e vet në "Facebook". Mes të tjerash, ai ka njoftuar se nga aktgjykimi kanë kuptuar se ankuesi ka dorëzuar prova shtesë. "Prandaj, kërkesa ka qëllim t'i sigurojë ato prova. Afati është 7 ditë për kthimin të një përgjigje në kërkesën e parashtruar", ka përfunduar Dervishaj.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Driton Selmanaj, ka kërkuar të enjten shkarkimin e ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci, pasi, sipas tij, ministrja e ka shkelur Kushtetutën. Ai ka thënë se po kërkojnë që të shkarkohet menjëherë ministrja Nagavci jo si akt moral, por si shkelëse e Kushtetutës. "MASHTI i ka çuar letër Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar prova se ku e ka shkelur Kushtetutën. As vendet që lidhje me demokraci nuk kanë nuk i bëjnë këto gjëra. Kjo është skandalozë", ka thënë

Selmanaj. Ai ka pyetur kryeministrin Albin Kurti se a mendon ende sikurse në vitin 2015, se kush e shkel Kushtetutën është superkriminel. "Kryeministri Albin Kurti në të kaluarën, në vitin 2015, kishte deklaruar se kush e shkel ligjin është kriminel, e kush e shkel Kushtetutën është superkriminel. Kryeministër, a mendon ende se kush e shkel Kushtetutën është superkriminel?", e ka pyetur Selmanaj. "Ndalni këto kërkesa ndaj institucioneve të pavarura, t'i ruajmë këto institucione sepse duke i ruajtur këto ne e ruajmë shtetin. Shkelësi i Kushtetues nuk e ka vendin në qeveri. Në rrethana të tjera vetë kryeministri do ta diskutonte ekzistencën e vet si kryeministër, sepse vartësit e tij po e shkelin Kushtetutën. T'i thuash Gjykatës Kushtetuese dërgomi provat, është njëjtë sikur t'i thuash një gjyqtari të Gjykatës Supreme tregomë pse e ke dënuar një kriminel", ka thënë Selmanaj. Ditë më parë Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka hedhur poshtë vendimin e Ministrisë së Arsimit për organizimin e mësimin alternativ të përshpejtuar dhe përcaktimit të organizimit të mësimin në objektet shkollore në komunën e Kamenicës. Pas këtij vendimi, ish-kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, në një deklaratë për medie ka thënë se ministrja Nagavci duhet të japë dorëheqje apo edhe të shkarkohet.

Partia Socialdemokrate ia ka dorëzuar të martën Arbërie Nagavci letërën e dorëheqjes nga pozita e ministres së Arsimit. Nënkryetari i PSD-së, Qëndron Kastrati, ka thënë se "sot ministres Nagavci ia dorëzuaam letërën e dorëheqjes së cilës i mungon veç nënshkrimi i saj". "Në përvjetorin e Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar që ka shkelur tri prej dokumenteve kyçe që ruajnë demokracinë në Kosovë; Kushtetutën, Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Veprimi i saj ndërhyrës ka shtrembëruar vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe ka dëmtuar potencialin jashtëzakonisht të dobishëm të reformës në arsim. Për veprimet e saj, ministrja Nagavci duhet të japë dorëheqje të menjëhershme", ka deklaruar Kastrati. Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka hedhur poshtë vendimin e Ministrisë së Arsimit për organizimin e mësimin alternativ të përshpejtuar dhe përcaktimit të organizimit të mësimin në objektet shkollore në komunën e Kamenicës. Gjykata ka theksuar se MASHTI-i përmes vendimit "ka tejkaluar kompetencën dhe ka cenuar përgjegjësitë komunale, përkatësisht ka ndërhyrë në kompetencat vetjake të komunës së Kamenicës përkritazi me ofrimin e arsimit publik, në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ligjore".

PDK-ja: Draftstrategjia e sigurisë kombëtare e hartuar nga qeveria Kurti ka mangësi serioze

PRISHTINË, 14 PRILL (ER) - Anëtarja e kryesisë e Partisë Demokratike të Kosovës, Besa Kabashi-Ramaj, në një konferencë për medie ka shprehur të enjten shqetësimin lidhur me mënyrën e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë nga qeveria Kurti.

Kabashi-Ramaj ka thënë se ky dokument me rëndësi të jashtëzakonshme për konsolidimin e sektorit të sigurisë në vend ka shumë mangësi dhe duhet rishikuar. "Dokumentit i mungon vizioni dhe qartësia se ku do të shkojë në dhjetë vitet e ardhshme dhe si. Dokumenti tregon shenja të qarta të mungesës së memories

institucionale dhe informacionit të përditësuar, gjë që nënkupton mungesën e një qasjeje gjithëpërfshirëse të qeverisë ndaj procesit të hartimit dhe rrjedhimisht një mospërfillje të Udhëzuesit për Hartimin e Dokumenteve Strategjike", ka theksuar ajo, duke shtuar se ky dokument tregon një mungesë serioze njohurish mbi temat që mbulon, si siguria njerëzore, mungesa e të kuptuarit të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare në terma moderne përballë një aparati kompleks kërcënimesh dhe rreziqesh.

Duke pasur parasysh buxhetin e Kosovës, ajo tha se financimi i

sektorit të mbrojtjes duhet të planifikohet mirë e të jetë i qëndrueshëm, dhe jo siç ishte kërkesa për fonde direkte nga qytetarët. "Qeveria Kurti, duke mos pasur program fare për sigurinë, nuk ka si të ketë përputhje me prioritetet për këtë sektor", ka deklaruar ajo.

PDK-ja e sheh si obligim t'i bëjë publike vërejtjet e veta për këtë dokument strategjik dhe shpreson që ato të merren parasysh nga hartuesit e saj, në mënyrë që strategjia të jetë e kompletuar.

"Strategjia Kombëtare e Sigurisë nuk është një dokument që duhet përfunduar, e lënë në sirtar.

Prandaj, një strategji pa vizion mbetet thjesht një dokument, por jo një hartë që mund të zbatohet, duke forcuar sigurinë e Republikës së Kosovës. Ky është dokumenti më i rëndësishëm në hapjen e rrugës drejt konsolidimit të sektorit të sigurisë në vend, dhe mbrojtjes së vendit e qytetarëve tanë. Qeveria aktuale duhet ta trajtojë me seriozitetin që e meriton. Në këtë aspekt, PDK-ja fton qeverinë që t'i marrë parasysh rekomandimet e dhëna. PDK-ja, gjithashtu, shpreh gatishmëri t'i vë në dispozicion të gjitha kapacitetet që ka në këtë fushë, për të arritur deri te një strategji kombëtare e cila realisht

kontribuon në ngritjen e nivelit të sigurisë në vend dhe mbrojtjen e qytetarëve tanë", ka thënë Kabashi-Ramaj.

Për t'i korrigjuar problematikat që ka Strategjia Kombëtare e Sigurisë, PDK-ja rekomandon që qeveria bashkë me Zyrën për Planifikim Strategjik dhe Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë ta rishikojnë të gjithë procesin e hartimit të këtij dokumenti; të bëjë një analizë të kujdesshme të implikimeve financiare; ta hartojë përsëri këtë strategji bazuar në informacionin e përditësuar mbi kërcënimet dhe rreziqet që mund t'i vijnë Kosovës; si dhe të krijojë një plan strategjik komunikimi.



Deputetët votojnë në parim Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 PRILL - Me 63 vota për deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar të enjten në parim Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Kryeministri Albin Kurti ka falënderuar deputetët që i dhanë mbështetje në parim një projektligji të rëndësishëm për sistemin prokurorial dhe jetik për shtetin e së drejtës. "Më në fund do të arrihet bilanci ndërmjet anëtarëve të përzgjedhur prokurorë dhe atyre joprokurorë. Në këtë mënyrë ligji i ri do ta zhvendosë diskutimin e takimeve të KPK-së nga interesat vetjake të



prokurorëve, tek interesat që kanë në fokus fuqizimin e sistemit prokurorial, veprimin energjik të prokurorëve dhe

aktakuzat e fuqishme të cilat nuk mundësojnë lirimin e kriminelëve me kusht, por sigurojnë zbatimin e ligjit për

kategori të tilla", ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se përbërja e ardhshme e Këshillit Prokurorial ka përgjegjësi të madhe e unike të tregojë se nga reforma e filluar mund të kontribuojë dukshëm në fuqizimin e sundimit të ligjit, të dëshmojë partneritet e bashkëpunim ndërinstitucional në çështjet e rëndësishme për vendin, duke mos tentuar ta arsyetojë mosveprimin me pavarësi të sistemit gjyqësor, por ta dëshmojë pavarësinë në ushtrimin e detyrave të përcaktuara me ligj. "Projektligji i votuar sot do ta ngrehë pashmangshëm llogaridhënien dhe transparencën në sistemin prokurorial, veti këto të domosdoshme e aq të munguara

brenda sistemit të drejtësisë", ka deklaruar kryeministri Kurti.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se ky projektligji i hap rrugë reformimit të sistemit prokurorial të Kosovës dhe i njëjti është hartuar edhe në konsultim me Komisionin e Venecias. "Ndryshimi më thelbësor është përbërja e këtij Këshilli, ku prej 13 anëtarëve që kishte, e vlerësuar si korporativizëm edhe nga Komisioni i Venecias, është reduktuar në shtatë anëtarë, me përfshirje të 3 anëtarëve joprokurorë, ku dy do të zgjedhën nga Kuvendi i Kosovës dhe një do të delegohet nga Avokati i Popullit", ka thënë ministrja Haxhiu.

Nura nënshkruan propozimin për hapjen e fabrikës katërmilionëshe

SKENDERAJ, 14 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka nënshkruar propozimvendimin për hapjen e një fabrike të industrisë së drurit dhe produkteve të betonit në këtë komunë, investim ky që ka vlerën e katër milionë eurove. Në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", Nura ka shkruar se çështja e zhvillimit ekonomik dhe papunësia janë problemet më të thella dhe më të mprehta me të cilat po bashkëjetojnë çdo ditë. "Në përputhje me legjislacionin

në fuqi, po i adresoj Kuvendit propozim-vendimin për hapjen e fabrikës së industrisë së drurit dhe produkteve të betonit në komunën tonë. Një investim në vlerën e 4 000 000 euro (katër milionë euro) që do të gjenerojë 100 vende pune. Pra, ky është programi dhe zotimi ynë që u kishim dhënë: 'Se nuk do të ndalemi së krijuari kushte për investime në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Sa më pak fjalë e më shumë punë!', ka shkruar Nura.



Komuna e Prizrenit dhe USAID Kosova fillojnë bashkëpunimin për kontratën sociale

PRIZREN, 14 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e USAID Kosova, të cilët kanë paraqitur programin 'Kontrata sociale'. Komuna e Prizrenit është përzgjedhur si komunë partnere për ciklin e ardhshëm

pesëvjeçar për zbatimin e programit për kontratën sociale. Kryetari Totaj ka bërë me dije se programi i USAID-it, "Kontrata sociale", ka për qëllim të ndërtojë praktika të qëndrueshme të pjesëmarrjes publike dhe ta forcojë partneritetin ndërmjet qeverisjes lokale dhe grupeve të

qytetarëve, në funksion të përmirësimit të kualitetit të jetës së qytetarëve të Kosovës. "Andaj ne u zotuar për bashkëpunim dhe përkushtim të plotë në mënyrë që ky program të ketë implementim sa më të mirë në komunën e Prizrenit", ka deklaruar Totaj.



Komuna e Mitrovicës, pjesë e projektit "ReLOaD"

MITROVICË, 14 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, i shoqëruar nga drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, ka pritur në takim përfaqësueset nga UNDP-ja, Vlora Elshani, Anita Smaloviç dhe Erita Deshishku.

Gjatë këtij takimi kryetari Hamza është njoftuar për projektin "ReLOaD" në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga UNDP-ja.

Nga përfaqësueset e UNDP-së u bë me dije se ka filluar faza e dytë e projektit "ReLOaD" (2021-2024) në Kosovë, pjesë e së cilës është edhe komuna e Mitrovicës, në kuadër të shtatë komunave partnere ku do të implementohet ky projekt. Me këtë rast, kryetari Hamza ka falënderuar UNDP-në për mbështetjen e dhënë duke



ofruar gatishmërinë për realizimin e projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve.

Komuna e Mitrovicës në kuadër të marrëveshjes së mirëkuptimit, gjatë fazës së parë të projektit "ReLOaD", ka përfituar mbështetje financiare në vlerë prej 33 mijë eurosh dhe është

kualifikuar për fazën e dytë. Projekti "ReLOaD" do ta mbështesë komunën e Mitrovicës me aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të stafit, asistencë teknike gjatë zbatimit të thirrjeve publike të pavarura dhe për fuqizimin e rinisë në territorin e Mitrovicës.

Komuna e Podujevës bën thirrje që të legalizohen ndërtimet pa leje

PODUJEVË, 14 PRILL (ER) - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e ka zgatur për herë të fundit afatin për aplikim për legalizim të ndërtimeve pa leje, i cili përfundon më 4 shtator.

Komuna e Podujevës përmes një njoftimi për medie ka theksuar se legalizimi është i rëndësishëm për arsye se bëheni pronar legjitim i pronës. "Legalizimi është i rëndësishëm sepse ju bëheni pronar legjitim i pronës dhe mund ta shfrytëzoni atë në bazë të qëllimeve tuaja si ta jepni me qira, ta shisni, ta dhuroni, të merrni kredi bankare, ta lëni hipotekë etj. Aplikimi për legalizim bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për komunën tonë", ka njoftuar komuna e Podujevës.

Taksa e legalizimit është shumë e ulët: kategoria I (që janë shtëpi deri 450 m², është 1 euro për m²), kategoria II (që nuk janë



shtëpi, është 2 euro për m²). "Megjithatë, nuk duhet të paguani taksë nëse: shtëpia juaj është ndërtuar me leje, shtëpia juaj është rindërtuar gjatë periudhës së pasluftës ose për shkak të trazirave sociale, jeni përfitues i skemës së asistencës sociale, ndërtimi juaj identifikohet në ortofoto zyrtare të vitit 2004. Certifikata e legalizimit lëshohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit brenda 60 ditëve pas aplikimit. Kjo certifikatë vërteton se prona juaj është regjistruar në Kadastër dhe se ju jeni pronar i ligjshëm i pronës", ka njoftuar komuna e Podujevës.

Kampanja për pastrimin e ambientit në Gjilan do të zgjasë nga 22 prilli deri më 5 qershor

GJILAN, 14 PRILL (ER) - Të enjten është mbajtur takimi i radhës i task-forcës për pastrimin e ambientit, të cilin e ka udhëhequr nënkryetarja e komunës së Gjilanit, Leonora Morina-Bunjaku. Në këtë takim, përpos drejtorëve komunalë,

kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të policisë, zjarrfikësve, kompanisë "Eco-higjiena" e disa OJQ. Nënkryetarja Morina-Bunjaku ka thënë se kampanja me moton "Ruaje natyrën, shpëtoje komunitetin" do të zgjasë nga 22 prilli deri më 5

qershor. "Përbrenda kampanjës do të ketë mesazhe edukuese për ruajtjen e ambientit, e aktivitete të shumta të pastrimit të ambientit. Mirëpo, qëndrueshmëria e këtyre aktiviteteve do të jetë 365 ditë", ka thënë nënkryetarja e

komunës. Në kuadër të këtyre aktiviteteve do të bëhet pastrimi i shkollave, pastrimi i deponive ilegale, vendosja e koshave të mbeturinave, mbjellja e drunjve dekorativë, pastrimi i shtretërve të lumenjve e aktivitete të tjera.



Reagim i KMDLNj-së

Kosova nuk ka pse të merret me Dick Marty, po e luan rolin e Pont Pilatit!

Më në fund u deklarua falsifikuesi i raportit politik të Këshillit të Evropës pas të cilit, me aktivitete zinxhirore, të kurdisura dhe të koordinuara, u imponua themelimi i një Gjykate Speciale kundër luftës së UÇK-së dhe bartësve kryesorë të kësaj lufte që tash janë të paraburgosur në Njësine e Paraburgimit në Hagë.

Dick Marty, si Pont Pilati, po mundohet t'i lajë duart nga përgjegjësia për arrestimin e ish-presidentit Hashim Thaçi dhe të tjerëve sikur edhe atyre që së shpejti do të arrestohen nga kjo Gjykatë njëetnike, si nga mentaliteti i veprimit ashtu edhe veshja me fakte krejtësisht në baza etnike, si të një kategorie të viktimave ashtu edhe të akuzuarve. Askush nuk e ka fajësuar Dick Marty alias Pont Pilati për arrestimin e drejtuesve dhe ish ushtarëve politikë dhe ushtarakë të UÇK-së e pas luftës edhe bartës të posteve më të larta institucionale dhe shtetërore por fajësohet dhe duhet të përgjigjet për një raport që strategjikisht e dëmton Kosovën, qytetarët e saj dhe luftën e drejtë për çlirim ku pika kryesore ishte pohimi se: "ndaj të ndaluarve në disa lokacione të Shqipërisë janë hequr në mënyrë të kundërligjshme organet e të cilat pastaj janë trafikuar për transplatin në vendet e treta...". Ky spekulim i paramenduar, pa e mbështetur me asnjë fakt e ka vënë Këshillin e Evropës para një akti të kryer siç ishte miratimi i këtij raporti, me këto akuzat të pambshtetura dhe të tmerrshme pas së cilës themelimi i kësaj gjykate u shndërrua në çështje teknike. Nuk është aspak i rëndësishëm pohimi se nuk ka



përgjegjësi për arrestimin e Hashim Thaçit dhe të tjerëve sa do të kishte rëndësi të tregojë të vërtetën se e ka manipuluar heqjen e organeve dhe trafikimin për qëllim transplantimi për faktin se kjo akuzë tashmë nuk përmendet në asnjërin nga akuzat e konfirmuara e që e forcon faktin se qëllimi i Dick Martyt ishte materializim i angazhimit të Rosisë dhe Serbisë për ta luftuar politikisht dhe jo vetëm politikisht Kosovën. Tash, çdo përpjekje nga ana e Kosovës që të merret me "kërcënimet për

jetën e Dick Martyt" është e tepërt dhe e panevojshme. Është joserioze politikisht që të kërkohen sqarime nga Zvicra për kërcënimet që i bëhen këtij manipuluesi të së vërtetës nga Serbia për faktin se kjo është çështje e brendshme e Zvicrës që duhet të zgjidhet me Serbinë. Dick Marty e ka përfunduar misionin në çastin kur e ka dorëzuar një raport politik të sajuar e që pastaj është votuar në Këshillin e Evropës. Është krejtësisht e parëndësishme nëse Dick Marty do të thirret si dëshmitarë në Gjykatën

Speciale aq më parë që ai nuk flet asgjë për prapavijën dhe qëllimin e kurdisur të këtij raporti por për kërcënimet që i bëhen nga Serbia. Dëshmia eventuale para Gjykatës Speciale e që KMDLNj mendon se nuk do të ndodhë, në kontekstin e shpallimit të frikës nga kërcënimet për jetë nga Serbia, pa e sqaruar prapavijën e akuzave dhe motivet që e kanë shtyrë që në raport të fusë heqjen e organeve me qëllim të trafikimit, pa asnjë provë konkrete, përveç se nuk i ndihmon fare të paraburgosurve në Hagë dhe Kosovës,

përkundrazi e legjitimon raportin spekulativ të Dick Martyt, Pont Pilatit. Dick Marty asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk është i rrezikuar nga Kosova, mund të rrezikohet nga ndërgjegjja e tij dhe mungesës së ndershmërisë profesionale sepse e ka damkosur rëndë Kosovën, qytetarët e saj, UÇK-në dhe luftën çlirimtare, në dobi që vetëm ai e din për ç'arsye, të një shteti që ka bërë krime monstruoze në Kosovë. Nëse Dick Marty është i gatshëm ta japë sqarime për akuzat monstruoze në raportin e tij që e ka bërë bashkë me Karla del Ponten, Hose Pablo Barajabar dhe sponsorisuesin që tashmë po e kërcënojnë me jetë BIA dhe Serbia, atëherë do të ishte në interes të Kosovës. Mos e popullarizoni një mashtrues dhe keqbërës që me bindje dhe paramendim ka bërë një raport që sjellë akuzat të tmerrshme për heqje të kundërligjshme të organeve e që nuk i ka mbështetur me asnjë fakt dhe të cilat as Gjykata Speciale nuk i përmend në asnjërin aktakuzë të konfirmuar. Kosova nuk ka përgjegjësi ta ruaj jetën apo shëndetin e një raportuesi të manipuluar apo manipulanti të vetëdijshëm që i ka bërë dëme strategjike dhe thujaja të pariparueshme Kosovës, qytetarëve të saj, të lirë, gjysmë të lirë apo që po mbahen në Hagë. Dick Marty nuk e ka hallin për të drejtat e viktimave e as Gjykata Speciale, ndryshe do të kërkoni përgjegjësi për ata që bënë krime në Kosovë kundër civilëve të pafajshëm sepse është e drejtë e njeriut të sigurohet drejtësia për viktimat dhe përgjegjësia për kriminelët, pa bërë asnjë dallim dhe në asnjë bazë!

Kosova dhe Maqedonia nënshkruajnë memorandum të bashkëpunimit në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë

PRISHTINË, 14 PRILL (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur të enjten në takim zyrtar homologen nga Republika e Maqedonisë së Veriut, ministren e Mbrojtjes, Slavjanka Petrovska. Përveç takimit dhe në nivel të delegacioneve, në këtë takim u nënshkrua edhe memorandum i mirëkuptimit lidhur me bashkëpunimin në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë. Me këtë rast, ministri Mehaj ka theksuar se me këtë memorandum synohet të bashkërendohet dhe sinkronizohet korniza ligjore, masat, veprimet dhe aktivitetet që sigurojnë zbatimin sa më të

suksesshëm të të gjitha marrëveshjeve tona. "Procesi i integrimit të Maqedonisë së Veriut është përvojë që do të ndajmë së bashku në procesin tonë integruar euroatlantik", ka deklaruar ministri Mehaj. Ministrja Petrovska ka shprehur gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit bilateral në mes të dy vendeve, duke ofruar përvojën e procesit të integrimit në strukturat euroatlantike, në të cilat ka kaluar Maqedonia e Veriut, si dhe mbështetjen në proceset përkatëse nga niveli i vendit anëtar të NATO-s dhe vizionit për paqe, siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm në rajonin tonë dhe më gjerë.



Rritja e pagës mund ta rrezikojë kontratën

PRISHTINË, 14 PRILL - Kur të rritet vlera e pagës minimale në Kosovë autoritetet përgjegjëse duhet t'i rritin edhe kontrollet në sektorin privat për t'u siguruar se ai e zbaton vendimin, thonë profesorët e ekonomisë. Ata thonë se rritja e pagës minimale është e nevojshme dhe e domosdoshme, por tërheqin vërejtjen se rritja mund ta shtojë edhe punësimin joformal si dhe të shkaktojë rritje të çmimeve.

Në mbledhjen e mbajtur më 13 prill, Qeveria e Kosovës miratoi projektligjin që i hap rrugë rritjes së pagës minimale në 250 euro neto. Paga minimale - e pandryshuar që nga viti 2011 - aktualisht është 130 euro për të punësuarit nën 35 vjeç dhe 170 euro për mbi 35-vjeçarët. Për të hyrë në fuqi rritja, projektligji duhet të miratohet në Kuvendin e Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se nga rritja do të përfitojnë 300 mijë punëtorë. Me projektligjin e ri punëtorët që marrin pagë minimale do të lirohen edhe nga tatimi. Kosova nuk ka të dhëna të sakta se sa është numri i të punësuarve që marrin pagë minimale, por besohet se ajo u takon më së shumti të punësuarve në sektorin privat. Sektori privat në Kosovë llogaritet si punëdhënësi më i madh: me më shumë se 220 mijë punëtorë.

Profesori i Ekonomisë, Musa Limani, thotë se vlera e pagës minimale, me gjithë rritjen, do të jetë e pamjaftueshme për shportën mujore, në kohën kur inflacioni në Kosovë është në rritje. Limani thotë se bizneset që

përballen me probleme financiare ose kosto më të lartë të shpenzimeve nuk do të mund të japin paga me rritje. Sipas tij, ato mund t'i rritin çmimet e produkteve ose të shërbimeve, ose të mbajnë punëtorë pa kontrata. "Me rritjen e pagës minimale do të rritet numri i punëtorëve pa kontrata, për arsye se disa biznese nuk kanë mundësi materiale ta paguajnë punëtorin në vlerën e pagës minimale. Ky do të jetë një problem më vete... do të paraqitet punësimi latent ose i fshehur. Në anën tjetër, do të ketë edhe mungesë të punëtorëve, sepse asnjë punëtor nuk do të punojë më nën vlerën e pagës minimale", thotë Limani për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, Qeveria e Kosovës i ka mekanizmat e vet, siç janë inspektorët e tregut, që duhet t'i kontrollojë bizneset private.

Kryetari i Odës së Afarizmit në Kosovë, Skender Krasniqi, thotë se qeveria duhet t'i ndihmojë bizneset për zbatimin e vendimit për rritje të pagës minimale. Qeveria, thotë ai, mund të krijojë përkohësisht lehtësira fiskale, përkatësisht t'i lirojë bizneset nga pagesa e TVSh-së për disa artikuj, ose ta subvencionojë një pjesë të pagës minimale.

Bizneset në Kosovë janë ankuar për humbje të mëdha për shkak të disa fazave të mbylles që ua ka imponuar pandemia e koronavirusit. "Në mënyrë që të mos rrezikohet largimi i punëtorëve dhe bizneset të mos kenë pasojë, qeveria duhet t'i kategorizojë bizneset me gjendje më të rëndë financiare për t'u



ofruar mbështetje. Në të kundërtën, do të rritet numri i punëtorëve pa kontrata pune, nuk do të paguhet obligimet në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe tatimi mbi pagën. Rrjedhimisht, do të ketë më pak të hyra në buxhetin e Kosovës", thotë Krasniqi për "Radion Evropa e Lirë".

Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, në një konferencë për medie ka thënë se vlera prej 250 eurosh e pagës minimale është e papranueshme. Sipas tij, ajo do të duhej të ishte së paku 400 euro. "... sepse, në bazë të

një analize të bërë, shporta mujore e një familjeje katëranëtarëshe në Kosovë kap vlerën e rreth 470 eurove", tha ai.

Për shkak të pandemisë së koronavirusit, çmimet e produkteve në Kosovë, sikurse në vende të tjera të botës, kanë nisur të rriten qysh vitin e kaluar.

Rritja ka vazhduar edhe pasi Rusia ka nisur luftën në Ukrainë, në muajin shkurt, pasi të dyja këto vende janë ndër eksportueset më të mëdha të grurit dhe produkteve të tjera. Sipas të dhënave zyrtare, inflacioni në muajin mars në Kosovë ka arritur në 10 për qind

krahasuar me muajin mars të vitit 2021.

Azemi, po ashtu, tha se tregu i Kosovës aktualisht ka "mungesë të theksuar" të fuqisë punëtore. "Nga mungesa e fuqisë punëtore shumë kompani private kanë filluar të mbyllen dhe kjo është situatë shqetësuese për vendin", tha ai.

Përfaqësues të punëtorëve kanë thënë më herët se pagat e ulëta, orari i stërzgjatur i punës, si dhe pasiguria në vendin e punës janë vetëm disa nga problemet që i largojnë punëtorët nga Kosova drejt vendeve evropiane.

Gripi i shpezëve dhe lufta në Ukrainë rritin çmimin e vezëve

WASHINGTON, 14 PRILL - Shpërthimi i gripit të shpezëve në Shtetet e Bashkuara dhe Francë po shtrëngojnë furnizimet globale të vezëve dhe po rritin çmimet e tyre ndërkohë që Ukraina ka ndërprerë dërgesat në Evropë dhe Lindjen e Mesme.

Çmimet më të larta janë veçanërisht të dhimbshme për konsumatorët që mbështeten te vezët si një burim me kosto të ulët të proteinave dhe zëvendësues për mishin më të shtrenjtë.

Gripi i shpezëve ka zhdukur më shumë se 19 milionë pula në fermat komerciale të ShBA-së këtë vit në shpërthimin më të keq që nga viti 2015.

Ndërkohë, Franca po vuan shpërthimin e saj më të keq ndonjëherë, në të cilin rreth 8 për qind e pulave që bëjnë vezë janë asgjësuar.

Kur shpendët infektohen, tufa të tëra shkatërrohen për ta frenuar sëmundjen, e cila shpesh përhapet nga zogjtë e egër.

Virusi vdekjeprurës dhe lufta në Ukrainë janë sfidat më të fundit



për furnizuesit e vezëve që po përballen me mungesën e fuqisë punëtore dhe kostot e larta për energjinë dhe drithin e përdorur për ushqimin e kafshëve.

Çmimet botërore të ushqimeve u rritën gati 13 për qind në mars, duke arritur një rekord të ri, pasi lufta në Ukrainë, në këtë eksportuese të madhe të grurit

dhe misrit, rriti çmimet e grurit, tha agjencia e ushqimit e OKB-së. Çmimet e vezëve pritet të qëndrojnë të larta, thanë prodhuesit, pasi do të duhen

muaj për t'i rifilluar operacionet në fermat e infektuara.

Infeksionet, gjithashtu, pengojnë punën në objektet që përpunojnë vezët në produkte si vezët e thata dhe vezët e lëngshme të përdorura në artikujt ushqimorë si përzierjet e ëmbëlsirave. "Industria e produkteve është në një panik të përgjithshëm", tha Marcus Rust, shef ekzekutiv i Rose Acre Farms, prodhuesi i dytë më i madh i vezëve në ShBA.

Virusi H5N8 është virus vdekjeprurës për shpezët në ferma dhe shpezët e egra. Në vitin 2021, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, shtatë punëtorë të një ferme u infektuan në Rusi me këtë virus. Ky virus është duke qarkulluar në fermat në vende të ndryshme të Evropës që nga viti 2014.

Sipas OBSH-së, infektimi me këtë virus i njerëzve konsiderohet shumë i ulët. Personat e infektuar duhet të mbikëqyren minimum dhjetë ditë për t'i kontrolluar simptomat.

Teza e një psikologu: Ja pse njerëzimi e “dashuron” luftën

Nga Marcus ASHWORTH

Nëse Vladimir Putin nuk i thërret mendjes së shpejti dhe nuk tërhiqet nga Ukraina, atëherë Rusia do të gjendet në prag të dëbimit për një kohë shumë të gjatë nga tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Çdo zotërues i obligacioneve të qeverisë ruse, është sot në hall të madh.

Qeveria ruse është përpjekur të shlyejë pagesat ndaj kreditorëve të saj, por Zyra e Thesarit të SHBA-së për Kontrollin e Pasurive të Huaja, po e shtrengon në mënyrë të pashmangshme dhe me profesionalizëm lakun për t'i ndalur këto flukse parash.

Po ashtu po mbyllen të gjitha rrugët dhe kanalet mbështetëse për kompanitë e lidhura me qeverinë ruse, për vazhdimin e shërbimit të borxheve të tyre. Agjencitë e vlerësimit të kredisë dhe ofruesit e indeksit të obligacioneve standarde, po i heqin obligacionet ruse nga bizneset e tyre.


Një falimentim zyrtar nga qeveria ruse ka të ngjarë të ndodhë brenda javëve të ardhshme. Në fakt Moskë ka pranuar krizën e rëndë që po kalon, duke kërcënuar me veprime ligjore, dhe duke thënë se do të ndalojë shitjet e bonove për pjesën

tjetër të vitit.

Se kë apo çfarë mund të padisë me sukses kjo mbetet e paqartë. Perspektiva e marrjes së borxheve të reja nga Rusia ishte zhdukur qëkur kjo e fundit nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Siç komentoi Ministri rus i Financave Anton Siluanov në gazetën ruse “Izvestia”, kostot e huamarrjes për çdo shitje obligacioni do të jenë “marramendëse”.

Do të kalojnë shumë vite përpara se ta shohim Rusinë që të fitojë qasje normale në tregjet ndërkombëtare për dollarë, euro apo monedha të tjera ndërkombëtare. Por Rusia po ndal edhe emetimin e rublës brenda vendit. Kjo nuk është edhe aq problematike, pasi Evropa paguan ende 1 miliardë dollarë në ditë për blerjen e energjisë ruse.

Por nëse sanksionet ndaj qymyrit do të pasohen nga ndalimet e blerjes së naftës dhe gazit rus, do të ndërpriteshin edhe këto flukse të ardhurash, dhe do të thellohej më tej paaftësia e Rusisë për të marrë hua. “Rusia nuk do të jetë në gjendje të shlyejë borxhet e saj ndoshta për një dekadë. Kjo do të thotë se ajo nuk do të ketë qasje në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, do të përballë me kosto shumë më të larta të huamarrjes, madje edhe nga kinezët nuk do të ketë investime,



mirite ekonomike, dhe qytetarët do të përballë me standarde më të ulëta të jetesës. Kjo është një perspektivë e tmerrshme për Rusinë dhe rusët” - thotë Tim Ash, strateg i tregjeve në zhvillim në kompaninë “Bluebay Asset Management”.

Zhvillimi më tronditës i ditëve të fundit është shpallja e gjendjes së falimentit nga Hekurudhat Ruse, që nuk kanë më mundësi të paguajnë borxhin e tyre. Dhe tani që është krijuar precedenti, edhe kompanitë e

tjera shtetërore do të kenë me siguri të njëjtin fat.

Nuk është përcaktuar ende për qindja për të cilën do të kompensohen zotëruesit e obligacioneve, edhe pse ka të ngjarë të jetë afër shumës së plotë të siguruar nga kompanitë e sigurimeve. Por ajo që është e rëndësishme për industrinë e financave, e cila ka përjetuar disa mosmarrëveshje mbi derivatet e kredisë, është se këtë herë sistemi po

funksionon siç është menduar.

Por huamarrësit rusë, përballen këtë herë me një situatë shumë më të rëndë sesa gjatë krizës së mëparshme të borxhit rus të vitit 1998, kur mungonin vetëm pagesat në rubla, ndërsa kreditorët në valutën e huaj u shlyen si zakonisht, ndërsa pjesa tjetër e botës u angazhua ta ndihmonte. Këtë herë, Rusia është izoluar. Ajo përballë me një krizë financiare të saj, të shkaktuar vetëm për fajin e vet.

Imazhet që tregojnë Mariupolin e shkatërruar, qytet port në Ukrainë



Qyteti i Mariupolit mbetet akoma objektivi i ushtrisë ruse, që për asnjë moment nuk ndali sulmet ajrore si dhe granatimet – duke shkatërruar pothuajse

gjithçka.

Në njërën anë Rusia pretendon se ka nën kontroll qytetin port, kurse Ukraina thotë se trupat e saj kontrollojnë qytetin me


rëndësi të madhe strategjike.

Megjithatë një gjë është e sigurt se ky qytet është shkatërruar pothuajse i tërë, pasi për afro 50 ditë është objektivi i ushtrisë ruse

që ka përdorur tërë arsenalin e mundshëm për të shkatërruar shtëpitë, ndërtesat, qendrat tregtare, spitalet e madje edhe teatrin që strehonte civilë.

Më poshtë ju sjellim galerinë që tregojnë pasojat e luftimeve të ashpra në këtë qytet të Ukrainës, që tashmë është shndërruar në qytet gërmadhash.





**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Organizatorët premtajnë spektakël në Final 4 e Ligës Unike

PRISHTINË, 14 PRILL - Final Four i Ligës Unike do të organizohet në Pejë. Të enjten është nënshkruar marrëveshja zyrtare ndërmjet anëtares së Bordit Drejtues të Ligës Unike, Elvira Dushku dhe drejtorit sportiv të KB Peja, Arbër Elshani.

Dushku ka premtuar se do të bëjnë çmos që ky organizim të jetë madhështor. "Pasi është organizuar me sukses Final 8 i Kupës së Kosovës në Pejë, tashmë presim që edhe Final 4 i Ligës Unike të jetë sa më madhështor dhe për këtë kemi marrë premtim nga klubi pejan. Stafi i Ligës Unike do të angazhohet maksimalisht që gjithçka të shkojë sipas planit dhe adhuruesit e basketbollit të shohin spektakël në parket.

Besoj se do të jetë angazhim për mrekulli", ka thënë Dushku në konferencën për medie që është organizuar në Zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Në anën tjetër, spektakël ka premtuar edhe Elshani. "Ne vetëm do t'i rritim standardet që kemi pasur në Final 8 Kupës së Kosovës. Kësaj radhe nuk kemi masa, andaj palestra do të jetë e stërbushur me tifozë. Kemi bërë të gjitha përgatitjet në vendosjen e skuadrave pjesëmarrëse dhe tifozëve. Sa për informatë, një biletë për të gjithë ndeshjet do të kushtojë 10 euro, kurse vetëm për një ndeshje 5 euro. Tifozët mysafirë i kanë ulëset e rezervuara dhe nuk besoj se do të jemi probleme. Besoj se do të jetë një

organizim i jashtëzakonshëm, ashtu siç i ka hije Ligës Unike, një ligë që është shumë e rëndësishme, pasi bashkon klubet nga Kosova dhe Shqipëria", është shprehur Elshani në konferencën për medie.

Dushku në fund ka thënë se shpërblimi total për të gjitha skuadrat është 25 mijë euro, ndërsa më pas u zbulua edhe logo e Ligës Unike.

ORARI

Të mërkurë takohen:
17:00 Golden Eagle Ylli-Teuta
20:30 Peja-Prizreni 16

Të enjten takohen:
17:00 Ndeshja për vendin e tretë
20:30 Finalja



Sot përballen Peja - Drita

PRISHTINË, 14 PRILL - Java e 27-të e Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll do të sjellë disa ndeshje mjaft interesante, ndërsa derbi zhvillohet mes rivalëve të vjetër, Sigal Prishtinës dhe Trepçës. Takimi i parë zhvillohet ndërmjet Pejës dhe Dritës. Pejanët janë favoritë, pasi kanë 17 fitore dhe nëntë humbje, ndërsa gilanasit kanë 26 humbje, në po aq takime, duke qenë skuadra e vetme pa fitore në elitë. Ndeshja e dytë zhvillohet mes rivalëve lokalë, Prizrenit 16 dhe Bashkimit.



Basketbollistët e Prizrenit 16 kanë 15 fitore dhe 11 humbje, ndërsa "portokallezinjtë" kanë

dhjetë fitore e 16 humbje, duke u renditur në vendin e shtatë dhe kërkojnë të hyjnë në zonën

e "play-off"-it, pasi kanë një pikë më pak se Rahoveci. Të dielën do të zhvillohet derbi i rivalëve të vjetër të basketbollit të Kosovës, Sigal Prishtinës dhe Trepçës. Prishtinasit kanë 13 fitore e 13 humbje, kurse mitrovicasit kanë 18 fitore e tetë humbje. Sfidat mes këtyre dy skuadrave kanë qenë gjithmonë interesante dhe kështu pritet edhe në këtë përballje. Sfida e fundit zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Golden Eagle Yllit. Vreshtarët kanë 11 fitore e 15 humbje, kurse therandasit

kanë 20 fitore e gjashtë humbje. Therandasit ndodhen në vendin e gjashtë, kurse kampionët në vendin e parë.

SUPERLIGA - Java 27

Të premten takohen:
17:00 Peja - Drita

Të shtunën takohen:
20:30 Bashkimi - Prizreni 16

Të dielën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Trepça
20:30 Rahoveci - Golden Eagle Ylli

Milani shpreh interesim për Zhegrovën

Klubi i Milanit ka shprehur interesim për futbollistin e Kosovës, Edon Zhegrova. Lajmi është dhënë nga gazeta e madhe italiane "Calciomercato". Raportohet se drejtuesit e Milanit po e vëzhgojnë situatën e Zhegrovës te Lille pas paraqitjeve

të mira që ka treguar në ndeshjet e fundit. Zhegrova iu bashkua kampionit në fuqi të Francës në janar nga Baseli dhe deri më tani ka shënuar dy gola në gjashtë paraqitje në Ligën 1. 23-vjeçari ka kontratë me Lillen deri në vitin 2026.

Gjakova e Re, kampion i Ligës së Dytë

Skuadra e Gjakovës së Re është shpallur kampion i Ligës së Dytë në basketboll në konkurrencën e meshkujve. Gjakova e Re edhe në ndeshjen e dytë finale të "play-off"-it ka mundur Kosovarin, kësaj radhe 65:50, duke u shpallur kampion dhe edicionin e ardhshëm do të garojë në

Ligën e Parë. Kupën kapitenit të skuadrës gjakovare, Erion Qarkagjia ia ndau Artan Kurti, nënkryetar i FBK-së. Medaljet i ka ndarë Artan Kurti, nënkryetar i FBK-së, Faton Kurshumlija, Komisar i Garave të FBK-së dhe Adea Roka, Drejtoreshë për Sport në Komunën e Gjakovës.

Fenerbahçe synon rikthimin e Muriqit

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, po përpiqet ta ndihmojë skuadrën e Mallorcës të qëndrojë në La Liga dhe në ndeshjen e fundit

i dha fitoren kundër Atletico Madridit, me një gol nga penalltia. Goli i sulmuesit nga Prizreni ishte i treti për të me fanellën e spanjollëve, por sërish shanset që të vijojë aty

janë të vogla. Ky huazim gjithsesi po shërben për mirë, pasi për Muriqin ka interesim sërish nga Turqia dhe Lazio mezi pret ofertat që ta shesë. Fenerbahçe synon ta rikthejë

sulmuesin në ekip, sipas asaj që shkruajnë mediet turke. Momentalisht nuk ka detaje për ndonjë ofertë kontratë apo shifra.



LeBroni tremb tifozët e lakersave: Dua një tjetër titull, por nuk vendosi unë

LOS ANXHELOS, 14 PRILL - Lakersat zhgënjyen këtë sezon në NBA, duke mos u kualifikuar dot për në fazën "play-off". LeBron Jamesi nuk luajti në ndeshjet e fundit për shkak të një problemi në kavigjell dhe do të qëndrojë pushim edhe 5-6 javët

e tjera. Në një intervistë pas përfundimit të sezonit, ai ka folur për të ardhmen e tij. "Në këtë moment është e rëndësishme të mendojmë për skuadrën që do ta kemi sezonin e ri. Duhet t'i gjejmë personat e duhur për të arritur më shumë

fitore. Gjithsesi, nuk jam unë ai që i marr vendimet se kush do të firmosë apo jo. Objektivi im është që të luaj në çdo cep të fushës", ka thënë James. "Personalisht, nuk kam vendosur një limit moshe para se të tërhiqem nga sporti.

Mendoj se mund të zhvilloj ende ndeshje me një nivel të lartë, siç dhe tregova këtë sezon. Kur erdha këtu doja të fitoja një titull dhe ia dola mbanë. Tani dua të fitoj një tjetër me Lakersin", ka shtuar James.



Simeone: Jam krenar se si kemi luajtur ndaj Cityt

MADRID, 14 PRILL - Atletico Madridi është eliminuar nga Liga e Kampionëve, por trajneri Diego Pablo Simeone ndihet krenar me ekipin e tij. Atletico barazoi pa gola në shtëpi me Manchester Cityn në ndeshjen e kthimit çerekfinale, por eliminohet pasi e kishte humbur ndeshjen e parë 0-1. "Kjo ndeshje shërben për nderin dhe krenarinë tonë, për krenarinë e njerëzve tanë që e kanë parë një skuadër luftëtare. Dhe na jep qetësi duke e pasur parasysh se skuadra dha gjithçka për ta kaluar këtë fazë. Publiku ishte fantastik gjatë tërë ndeshjes dhe skuadra është përgjigjur mirë, duke u munduar ta bëjë atë që është e vështirë të shihet nëpër stadione. Sa i përket kartonit të kuq të Felipers, nuk e kam kuptuar se çka ka ndodhur, isha shumë larg, por gjyqtari më tha se e ka shqelmuar një lojtar të tyre, unë nuk e kam parë", ka thënë Simeone. "Sa i përket humbjes së kohës, nuk ka çka të flitet shumë. Është gjyqtari ai



që i menaxhon këto situata. I bëj komplimente Cityt për lojën e madhe që e zhvilloi dhe e përgënjeshtroj faktin se i kam duartrokatur Guardiols për faktin se skuadra e tij ishte duke humbur

kohë. E bëra sepse i vlerësova përpjekjet që ata po i bënin në fushë. Ndihej keq që dolëm kështu, por jam krenar për atë që jemi dhe se si kemi luajtur", ka shtuar Simeone.

Ikona e atletikës: Ky është sezoni im i fundit

WASHINGTON, 14 PRILL - Atletja amerikane Allyson Felix, një nga sprinterët më të mëdha në historinë e sportit të "mbretëreshës", ka vendosur të tërhiqet në fund të këtij sezoni në moshën 36-vjeçare. Në karrierën e saj ajo ka fituar 7 medalje të arta olimpikë, 3 të argjendta dhe 1 të bronzitë. Felix ka triumfuar në 4 olimpiadat e fundit (Pekin, Londër, Rio de Zhaneiro dhe Tokio), duke qenë një ikonë e atletikës. Felix, që mban rekordin botëror në stafetat 4x100 dhe 4x400 metra, përmes një publikimi në rrjetet sociale shkruan: "Kam qenë një vajzë e vogël, që më thërrisnin 'kofshë-pulë'. Por ky sport më ka ndryshuar jetën dhe për këtë i jap përgjithnjë mirënjohës. Kam dhënë gjithçka në gara dhe për



herë të parë në jetën time nuk jam e sigurt nëse mund t'i jap më ndonjë gjë këtij sporti". "Dua t'i falënderoj të gjithë ata që më kanë ndihmuar për realizimin e kësaj ëndre. Ky sezon do të jetë i fundit për mua. Gara ime e fundit. Nuk do të jetë një numërim mbrapsht, por një sezon gëzimi. Nëse do të

më shihni në pistë shpresoj të ndani me mua një moment, një gëzim, një kujtim. Ku do të jetë sezoni final, ku do të garoj për gratë, për vajzën time, për një botë më të mirë për gratë", ka shkruar Felix, që ka fituar edhe 13 medalje të arta në botërorë, 3 të argjendta dhe 2 të bronzta.

SHKURT

Pele solidarizohet me Ukrainën

Legjenda Pele vijon të luftojë me problemet me shëndetin teksa po bën disa kimioterapi. 81-vjeçari duket se po ndjek gjithçka që ndodh në botë dhe me një status në "Instagram" ai ka reaguar i përbotshëm për luftën në Ukrainë dhe jo vetëm. "Vitet kalojnë, por pak ka ndryshuar që kur isha fëmijë. Trageditë që kemi përjetuar tashmë duhet të na kishin mësuar të ndërtonim një botë më paqësore. Unë i dërgoj solidaritetin tim popullit të Ukrainës. Jam në lutje, duke i kërkuar Zotit që të mbizotërojë paqja, liria dhe dashuria", ka shkruar Pele.

PSG-ja firmos marrëveshjen me sponsorin e ri, në paraqitje mungon Mbappe

PSG-ja ka mbyllur një marrëveshje trevjeçare me firmën e veshjeve të përditshme GOAT. Ky slogan do të shfaqet në mëngët e fanellës së sezonit të ardhshëm, ndërsa së bashku me Qatar Airways do të jenë dy sponsorët kryesorë të parisienëve. Nga marrëveshja me GOAT, PSG-ja do të përfitojë 50 milionë euro për tre vjetet e ardhshëm. Ajo që ka bërë më shumë përshtypje është fakti se në reklamën e zyrtarizimit të kësaj marrëveshje mungon Kylian Mbappe. Francezi mbetet i paqartë në aventurën që do ta ndërmarrë sezonin e ardhshëm pavarësisht prej interesit të madh të Real Madridit. PSG-ja këmbëngul ta mbajë lojtarin për shumë vjet, për ta shndërruar në një ikonë të klubit, ndërkohë që vetë 23-vjeçari duket se është lëkundur dhe shpeshherë ka theksuar se ende nuk e ka marrë një vendim.

Shumë klube në garë për Eriksenin

Kapiteni i Danimarkës, Christian Eriksen, po paraqitet mirë për Brentfordin. Futbollisti danez u rikthye në fillim të vitit pas sulmit në zemër që e kishte pësuar verën e kaluar në Kampionat Evropian. Megjithatë, ai i shtrëngoi dhëmbët dhe e vazhdoi karrierën pasi e vendosi një defibrilator në zemër. Tash Erikseni po e gëzon një formë të shkëlqyeshme, ndërsa u rikthye edhe në Kombëtaren e Danimarkës. Mediet britanike shkruajnë se paraqitjet e mira ish-futbollistit të Ajaxit, Tottenhamit dhe Interit do t'i shpërblehen gjatë verës që vjen. Në fakt, mesfushori kreativ pritet të largohet nga Brentfordi, shkruan "Northern Echo". Atij ia kanë vënë syrin disa klube të Premierligës si Newcastle, Evertoni, West Ham Unitedi dhe ish-klubi i tij, Tottenham. Mbetet të shihet nëse Erikseni do t'i mbetet besnik Brentfordit apo do ta bëjë një hap përpara, duke iu bashkuar një klubi më të madh anglez.

Guardiola: U mbrojtëm se nuk kishim zgjedhje tjetër

Manchester City u kualifikua në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve dhe Pep Guardiola u fut në histori, pasi ka shkruar 9 herë në këtë fazë, 4 herë me Barcelonën, 3 herë me Bayernin dhe dy herë me "Qytetarët", si asnjë trajner tjetër. Kundër

Atletico Madridit anglezët vuajtën dhe trajneri spanjoll pas ndeshjes deklaroi: "Në pjesën e dytë ata luajtën më mirë, nuk arritëm ta rikuperonim topin shpejt. Në 180 minuta, ata luajtën më mirë vetëm në 45 minutat e fundit. Nuk mund të

bëjmë gjithmonë nga 3-4 gola. Nuk e zotëruam topin dhe nuk mund të dominonim në pjesën e dytë. U mbrojtëm? Nuk kishim zgjedhje tjetër. Tani le të festojmë. Për ne është një sukses i madh dhe jam shumë i lumtur që arritëm këtë objektivi. Në pjesën e

parë kishim mundësi për të shënuar, por në përgjithësi e meritua kualifikimin. Atletico na detyroi të mbroheshim. Nuk na pëlqen, por nuk kishim zgjedhje tjetër. Publiku e mbështeti shumë skuadrën kundërshtare. Kisha thënë që ka

skuadra që mbrohen me shumë lojtarë dhe atyre është e vështirë t'u bësh gol. Shtypi thotë që Simeone luan gjithmonë në të njëjtën mënyrë. Unë kam thënë gjithmonë fjalë të mira për Atletico", ka përfunduar Guardiola.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 269/1
 Datë: 14.04.2022

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 29.03.2022 së shkollës Sh M L P “Qendra e Kompetencës”, në Prizren shpallë:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të ShMLP „Qendra e Kompetencës” në Prizren, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjencionit turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencionit turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi për marreveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit (KA të klasëve të 12-ta e ka preferuar javën e dytë të muajit Maj – 3 netë e 4 ditë)
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencionit turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulturo-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2019-2020-2021)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulësve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencionit të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrësi i vjetër, Shkodër, Krujë, Berat, Vlorë etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi më i ulët ofertues (Lartësia maximale e vendosur nga KDSH është 100 Euro)
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfuturës do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorëzohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndërsa MASHT-i II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)
 Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus nje ditë), ndërsa agjenda mund të ndërroj varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 272 /1
 Dt:14.04.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendre e Kompetencës “11 Marsi”, në Prizren për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi i lirë/ Zëvendësim
ShML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Një mësimdhënës/e për lëndët e ndërtimtarisë me 20 orë mësimore	Zëvendësim deri nga kthimi i mësimdhënies nga pushimi i lehonisë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoh udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës “11 Marsi”, në Prizren.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
- Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

Drejtoria e Gjmnazit "Gjon Buzuku" në Prizren

Nr. prot: 502, të datës 14.04.2022

Prizren

Bazuar në nenin 11, të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016 dhe në vendim nr. Prot: 501 të datës 14.04.2022, të të KDSH-së, Gjmnazi "Gjon Buzuku" në Prizren, shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të Gjmnazit "Gjon Buzuku" në Prizren

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të Gjmnazit "Gjon Buzuku" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datë 09.05.2022 deri më 13.05.2022.

Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Kriteret e përgjithshme:

- Certifikatën e biznesit me informata për biznesin,
- Vertetimin e Administratës Tatimore
- Vertetimin për pagesën e taksave komunale për vitin 2021
- Licencën e transportit ndërkombëtar "D"
- Certifikatat e autobusave sipas licences "D"
- Referencat rreth organizimit të ekskursioneve me maturantë për vitet 2017, 2018, 2019
- Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli teknik
- Kopjen e sigurimit të autobusëve, patentshoferëve të vozitësve dhe certifikata e kompetencës profesionale CPC
- Certifikatat mjeksore për vozitësit
- Agjensioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Autobusët të jenë në pronësi, komfor me klimë dhe në numër të mjaftueshëm për mbi 400 vende.
- Kompania të siguroj mjekun (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut).
- Licencën e agjensionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve
- Dëshmi për hotelin e ofruar në Durrës për datat 09.05.2022- 13.05.2022.
- Të prezantohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit, nr.telefonit i pronarit dhe adresa.
- Hoteli të posedoj mbi 400 shtretër. Të posedoj banjo dhe ujë të mjaftueshëm.
- Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës.
- Të prezantohet menyuja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për pesë ditë qëndrimi.
- Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa hyrëse nëpër monumente sipas itinerarit të përcaktuar nga KDSH.
- Agjensioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit (2019, 2020 dhe 2021) së paku 250 000 euro.
- Hoteli të posedoj sallë për argëtim për nxënës dhe të mos shërbehen apo lejoj shitjen dhe përdorimin e pijeve alkoolike në tërë hapësirën e hotelit.
- Licencën e sallës për argëtim për së paku 400 nxënës.
- Oferta për nxënës të liruar nga pagesa.

Vërejtje: Kompania Turistike fituese në përfundim të eskursionit duhet t'i siguroj nënshkrimet nga: Drejtori i shkollës, përfaqësuesi i Këshillit të prindërve si dhe nga përfaqësuesi i Këshillit të nxënësve, për përmbushjen e kushteve të përcaktuara sipas kriterëve të lartëcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

P.s. Lartësia e pagesës 120 euro

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimit mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë nga dita e publikimit në gazetë.

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA.02/2016 më datë 22.04.2022 në ora 14:00 në DKA-Prizren

Pas hapjes së ofertave, Komisioni do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga kompanitë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.

Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania Turistike e përgjegjshme me çmimin më të ulët të ofertës.

Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Seven Seas Maritime Services Spain S.A." ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810796550 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Seven Seas Maritime Services Spain S.A." donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810796550 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Seven Seas Maritime Services Spain S.A." has come to the decision to quit its business: 810796550 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:

044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Renedent" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 810851081, nrb. 71187934.

► "Sri Consulting" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811889552.

► "Vezë Fan" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811889726.

► Rebeka Lohaj shpall të pavlefshëm letërnjoftimin me numër: 1174178352 të lëshuar nga MPB-ja me datë 07.09.2016.

► Avdyll Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme gjmnazit "Hajdar Dushi"-Gjakovë.

► Endrit Halilaj nga Lipoveci i Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Shaban Golaj".

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.


► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA



Thirrje për punë praktike me pagesë

Organizata Oda e Mjekëve të Kosovës, shpall njoftimin publik, për internship.

Programi i praktikës profesionale (internship) do të zhvillohet pranë zyrave të OMK-së për një periudhë 2 mujore.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore që do të ushtrohen gjatë realizimit të internship-it janë:

- Asistimi në përgatitjen e materialeve, mbledhjen e raporteve për komisionet e përhershme të Odës.
- Sistemin e materialeve në formë fizike dhe elektronike.
- Asistimi i stafit në realizimin e aktiviteteve që zbaton organizata.
- Angazhimi me detyra të tjera të natyrës administrative sipas rastit.

Kandidati ose kandidata i/e interesuar për këtë pozicion duhet të plotësojë këto kritere:

- Të jetë duke ndjekur vitin e tretë të studimeve në nivelin Bachelor ose studimet në nivelin Master, në fushat që konsiderohen se i kontribuojnë qëllimit të detyrave më lartë.
- Përparsi konsiderohet njohëja e gjuhës angleze dhe të jetë përdorues shumë i mirë i programeve bazë të kompjuterit.
- Të ketë aftësi të mira të komunikimit dhe të punës në grup.

Mënyra e Aplikimit

Të interesuarit mund të aplikojnë përmes emailit: info@omk-rks.org deri me datë 29 Prill 2022 me subject "Aplikim për punë praktike". Aplikimet e dërguara pas afatit nuk do të merren në konsideratë.

Të interesuarit të dërgojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. CV
2. Letër motivimi (jo më shumë se 500 fjalë)
3. Kopje të dokumentacionit shoqërues që vërteton përbushjen e kriterëve të parashikuara në pikat "1", "2" më sipër

Mënyra e përzgjedhjes

Një komision paraprak seleksionimi brenda organizatës OMK, do të vlerësojë të gjitha aplikimet e kandidatëve të interesuar. Vetëm kandidatët që do të përzgjidhen në një listë të shkurtër do të njoftohen brenda datës 05 Maj 2022, për një intervistë me komisionin e seleksionimit të kandidatëve në fazën e dytë të rekrutimit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Flori A 1" SH.P.K. – Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb: 810106436 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Flori A 1" D.O.O. iz Gjakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810106436 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Flori A 1" L.L.C. in Gjakova, has come to the decision to quit its business: 810106436 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA



Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Neni 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ZYRTAR/E ADMINISTRATIV/E PËR KOMISIONE TË PËRHERSHME

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 01/2022

Kohëzgjatja e Kontratës: 6 muaj, me mundësi vazhdimi (Orar i Plotë, Zëvendësim i Pushimit të Lehonisë)

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Merr pjesë në mbledhje të organeve të Odës dhe komisioneve të përhershme të Odës me qëllim të ofrimit të asistencës;
- Mbanë evidencën e mbledhjeve të komisioneve të përhershme të Odës dhe organeve të tjera ku kërkohet;
- Siguron materialet e nevojshme për mbarëvajtje të mbledhjeve të komisioneve të përhershme;
- Mbanë dhe përgatit procesverbalet e takimeve;
- Mirëmbanë dosjet e komisioneve të përhershme;
- Ndihmonë anëtarët e komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OMK-së si dhe palëve të tjera;
- Kujdeset për zhvillimin e proceseve që ndërliken me vendimmarrjen e komisioneve të Odës; dhe
- Kryen dhe punë të tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe sipas nevojave të organeve të Odës dhe shërbimit profesional në përgjithësi.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Udhëheqësi i Zyrës për Administratë dhe Financa

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë të kryer Fakultetin në fushat relevante, niveli bachelor;
- Një (1) vitë përvojë pune në administratë;
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi;
- Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shqollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letër-njoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subject të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 14/04/2022 deri më 29/04/2022, ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 049/872-300 apo 038 / 544-872.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

